

VENDIM
Nr. 62, datë 3.2.2017

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2017, PËR
AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2017, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), në shumën 363 020 000 (treqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e njëzet mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PASQYRA NR.1

**PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE
PËR VITIN 2017**

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017
1.	Shpenzime personeli	92.5
2.	Shpenzime për politika të reja pagash	5
3.	Shpenzime për materiale	7.9
4.	Shpenzime për shërbime	110.07
5.	Shpenzimet për investime	147.55
	Totali	363.02